



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 51

Tiranë – E mërkurë, 31 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 33/2021, datë 16.3.2021	Për Gardën e Republikës së Shqipërisë..... 5329
Dekret i Presidentit nr. 12056, datë 29.3.2021	Për shpallje ligji..... 5346
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 23.3.2021	Për një shtesë në numrin organik të punonjësve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2021..... 5346
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 176, datë 24.3.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar..... 5347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 181, datë 25.3.2021	Për krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e zonës doganore, Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit..... 5347
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 18, datë 24.3.2021	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga banka e parë e investimeve, Albania sh.a..... 5351
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 1, datë 19.3.2021	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”..... 5351
Urdhër i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 19, datë 26.3.2021	Për delegim kompetence..... 5352
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 84, datë 4.3.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a..... 5352

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 85, datë 4.3.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 40, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Tropojë”.....	5354
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 86, datë 4.3.2021	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë sh.a.”.....	5355
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 87, datë 4.3.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Lushnjë sh.a.....	5355

**LIGJ**
Nr. 33/2021**PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË**
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Gardës së Republikës, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësve.

Neni 2
Misioni

Misioni i Gardës së Republikës është garantimi i sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje, mision i cili nuk ndryshon në gjendje të fatkeqësisë natyrore, të jashtëzakonshme ose në gjendje lufte.

Neni 3
Statusi

1. Garda e Republikës është institucion i administratës shtetërore, person juridik, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

2. Punonjësi i Gardës së Republikës, për shkak të veçorive të detyrës, si dhe të rrezikut të jetës e të shëndetit të tij, gëzon status të veçantë.

Neni 4
Parimet e veprimtarisë

Parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të Gardës së Republikës janë:

- a) ligjshmëria;
- b) mosdiskriminimi;
- c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ç) proporcionaliteti;
- d) pavarësia operationale;
- dh) paanshmëria politike;
- e) integriteti, merita dhe profesionalizmi;
- ë) transparenca;
- f) ruajtja e informacionit të klasifikuar;
- g) kontrolli dhe llogaridhënia.

Neni 5
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Armatim dhe pajisje personale” janë armët, pajisjet dhe mjetet individuale të përcaktuara për çdo funksion në tabelën e organizimit dhe të pajisjeve të strukturave të Gardës së Republikës, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë.

2. “Armatim dhe pajisje kolektive” janë armët, pajisjet dhe mjetet për përdorim kolektiv nga strukturat e Gardës së Republikës, të përcaktuara në Tabelën e Organizimit dhe të Pajisjeve të Strukturave të Gardës së Republikës.

3. “Burime të hapura” janë përmbajtja e informacioneve të dhëna nga media e shkruar dhe elektronike ose deklarata publike të personaliteteve dhe individëve, të cilat lidhen me veprimtarinë e Gardës.

4. “Gatishmëri” janë nivelet e ndryshme të gjendjes, në të cilën strukturat e Gardës zhvillojnë aktivitetin dhe marrin masa përkatëse për sigurinë e personaliteteve, objekteve në ruajtje dhe të detyrave të tjera ligjore, të përcaktuara në rregulloren e Gardës së Republikës.

5. “Gradë” është shprehje e hierarkisë, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, e eksperiencës dhe e përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në



Gardën e Republikës, që fitohet nga punonjësi i Gardës nëpërmjet një procesi konkurrues.

6. “Informacion i klasifikuar” është çdo njohuri që mund të komunikohet ose dokumentohet, pavarësisht nga forma, që është nën kontrollin e strukturave shtetërore dhe është i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi.

7. “Ministri”/“ministra” është ministri/a përgjegjës/e për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

8. “Mbrotjtje” është veprimtaria kryesore e personelit në detyrë, si dhe e strukturave të Gardës për të garantuar paprekshmërinë e personaliteteve dhe të objekteve në ruajtje nga kërcënimet, rreziqet dhe sulmet e mundshme.

9. “Ruajtje” është veprimtaria e përditshme, që ka për qëllim mbikëqyrjen e personalitetit dhe të objektit nga rreziqet e mundshme.

10. “Objekt i rëndësisë së veçantë” është objekti i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave që, për shkak të rëndësisë dhe veprimtarisë që zhvillohet në të, ruhet dhe mbrohet nga Garda.

11. “Objekt në ruajtje” është çdo ndërtesë dhe hapësirë private ose publike, segmente rrugore, ku qëndrojnë, kalojnë dhe zhvillojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme ose të përkohshme personalitetet e vendit dhe të huaja. Këto objekte gëzojnë statusin e rëndësisë së veçantë gjatë kohës që janë në dispozicion të personaliteteve dhe ruhen nga personeli i Gardës.

12. “Pajisje kufizuese” janë pajisjet që përdor Garda në situata të veçanta, më qëllim përmbushjen e misionit.

13. “Personalitete të larta shtetërore” janë Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, si dhe homologët e tyre kur vizitojnë vendin tonë.

14. “Personalitete shtetërore” janë personat e emëruar ose të zgjedhur, që kryejnë funksione të një rëndësie të veçantë në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ose homologët e tyre kur vizitojnë vendin tonë.

15. “Punonjës i Gardës së Republikës” është punonjësi me gradë, marrëdhëniet e punës së të cilit rregullohen sipas këtij ligji.

16. “Punonjës administrativ i Gardës së Republikës” është punonjësi pa gradë,

marrëdhëniet e punës së të cilit rregullohen sipas Kodit të Punës.

17. “Përdorimi i forcës” është veprimi i drejtpërdrejtë, i cili ushtrohet nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera të posaçme në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

18. “Siguria” është tërësia e masave të marra për të mbrojtur personalitetet dhe objektet në ruajtje.

19. “Situatë emergjente” është një situatë e rrezikshme që përbën një kërcënim serioz, e cila ndikon ose mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në sigurinë e personaliteteve dhe të objekteve.

20. “Trajnim” është përgatitja profesionale dhe fizike, në mënyrë periodike dhe të vazhduar, për të ruajtur e përmirësuar parametrat dhe performancën e punonjësve për përmbushjen e përgjegjësiave funksionale.

21. “Arsimim dhe kualifikim institucional” është tërësia e njohurive dhe shprehive që u jepen punonjësve të Gardës së Republikës nëpërmjet kurseve, pjesë e strategjisë/politikave të arsimit të personelit të Gardës së Republikës.

22. “Vërtetim i besueshmërisë” është dokumenti, i cili pasqyron rezultatet e verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruar në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të administruara nga Policia e Shtetit dhe institucione të tjera shtetërore për shtetasit që pranohen ose ripranohen në Gardë.

23. “Verifikim i pastërtisë së figurës së punonjësit” është proces verifikimi, shqyrtimi dhe vlerësimi, që i referohet kryerjes së një kontrolli të kujdesshëm periodik për të gjithë punonjësit e Gardës dhe për raste të veçanta para emërimit të punonjësit në një detyrë të rëndësishme që kërkon ruajtjen e sekretit, besueshmërinë, besnikërinë e përshtatshmërinë për një detyrë që ka të bëjë me sigurinë e personaliteteve.



KREU II ORGANIZIMI, VEPRIMTARIA DHE FUNKSIONIMI

Neni 6

Organizimi i Gardës së Republikës

1. Garda organizohet në struktura hierarkike në nivel drejtorie të përgjithshme, zëvendësdyrëtor i përgjithshëm, drejtorie, sektori, seksioni.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Gardës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Gardës.

Neni 7

Detyrat

1. Garda e Republikës ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra kryesore:

a) organizon dhe kryen ruajtjen dhe mbrojtjen fizike të personaliteteve;

b) organizon dhe kryen ruajtjen, mbrojtjen e brendshme e të jashtme të objekteve;

c) kryen shërbim ceremonial sipas përcaktimeve ligjore të ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë;

ç) përcakton zonën e sigurisë, skemat e ruajtjes së bashku me planet e dislokimit, ato operacionale, si dhe vendos kontaktet me institucionet ligjzbatuese në interes të ruajtjes dhe mbrojtjes së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;

d) parandalon rrezikun e çastit nga persona që tentojnë të cenojnë integritetin fizik të personaliteteve, që tentojnë të dëmtojnë imazhin e tyre apo dëmtojnë objektin në ruajtje;

dh) bën verifikimin e identitetit të personave para se të hyjnë në objektet në ruajtje;

e) grumbullon e përpunon informacione nga struktura të tjera të sigurisë në vend ose nga burime të hapura, me qëllim parandalimin e veprimtarisë kriminale keqdashëse/keqbërëse ndaj personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;

ë) grumbullon, vlerëson, analizon, shpërndan dhe përdor informacion për nevoja të

parandalimit e zbulimit të autorëve të veprave penale ndaj personaliteteve të vendit dhe të huaja që vizitojnë vendin tonë;

f) bën kontrollin fizik të personelit të administratës dhe të personave të tjerë, si dhe të çdo bagazhi të tyre, para se të hyjnë në objektin që ka në ruajtje, për praninë e armëve, sendeve ose lëndëve të tjera me rrezik;

g) kryen kontrollin paraprak dhe të vazhdueshëm të objekteve në ruajtje, të hapësirave publike ose private, të pajisjeve, të mjeteve të transportit dhe të bagazheve në vendet që do të shkojnë personaliteti;

gj) kryen kontrollin e dërgesave, pakove, dhuratave dhe sendeve të tjera në objektet në ruajtje, për praninë e lëndëve me rrezik, para se t'u shkojnë personaliteteve;

h) bllokun pjesë rrugësh ose mjedise publike apo private, ndalon e urdhëron zhvendosjen e mjeteve nga vendparkimi për aq kohë sa është e nevojshme, për nevoja të sigurisë ose në kushtet e emergjencës, vetë ose në bashkëpunim me struktura të tjera ligjzbatuese;

i) merr masa për bllokimin e valëve transmetuese për të gjitha pajisjet ose në mënyrë përzgjedhëse në zonat ku personalitetet ushtrojnë aktivitet, kur e gjykon të domosdoshme;

j) merr masa për sigurinë e rendit në sallën e zhvillimit të seancave plenare të Kuvendit, në mjediset e brendshme të Presidencës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrit përgjegjës për punët e jashtme;

k) i bën të njohur personalitetit një situatë të pritshme rreziku për jetën, shëndetin, integritetin e tij, duke i sugjeruar të mos zhvillojë aktivitetin, lëvizjen, qëndrimin, takimet dhe, për këto raste, drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës informon ministrin;

l) bashkëpunon e bashkëvepron me Policinë e Shtetit dhe shërbimet inteligjente për ruajtjen e mbrojtjen e personaliteteve dhe të objekteve në ruajtje, sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshje të përbashkët ndërmjet drejtuesve të strukturave;

ll) bashkëpunon me strukturat shtetërore që ofrojnë shërbimin e urgjencës dhe kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit;

m) bashkëpunon e bashkëvepron me persona fizikë e juridikë, shtetërorë e privatë për ruajtjen



e mbrojtjen e personaliteteve dhe të objekteve në ruajtje;

n) përdor pajisje të posaçme për kufizimin e veprimeve të personave që përbëjnë rrezik për personalitetin ose objektet në ruajtje;

nj) përdor armët e zjarrit në organikë të Gardës, sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit;

o) vlerëson informacionin që përbën rrezik për personalitetet e objektet në ruajtje dhe, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe struktura të tjera ligjzbatuese, merr masat e nevojshme për shmangien e çdo veprimi të dëmshëm për personalitetin ose objektin.

p) bashkëpunon me protokollin e shtetit dhe institucionet homologe të vendeve pritëse, përgjegjëse për sigurinë e personaliteteve, për organizimin e masave të sigurisë kur personaliteti qëndron jashtë vendit.

2. Rregullat e procedurat për zbatimin e këtyre detyrave përcaktohen në rregulloren e Gardës së Republikës.

Neni 8

Nivelet e gatishmërisë

1. Garda e Republikës e kryen veprimtarinë dhe përmbush përgjegjësinë e saj duke u organizuar në këto nivele gatishmërie:

a) niveli i gatishmërisë normale, “E gjelbër”, përcakton regjimin e punës ose të shërbimit në situatë normale të përditshme;

b) niveli i gatishmërisë së përforcuar, “Portokalli”, përcakton regjimin e punës me shërbim të përforcuar, me personel e struktura shtesë;

c) niveli i gatishmërisë së lartë, “E kuqe”, përcakton shërbimin në situatë me risk të lartë, real dhe të vazhdueshëm për misionin e Gardës.

2. Nivelet e gatishmërisë në Gardën e Republikës mund të aktivizohen për të gjitha strukturat e saj ose për struktura të veçanta, bazuar në detyrat e marra e situatat e krijuara në kuadër të përmbushjes së misionit nga ana e tyre.

3. Rregullat, procedurat dhe kompetencat për kalimin nga një nivel gatishmërie në tjetrin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 9

Bashkëpunimi

Për përmbushjen e misionit të saj, Garda e Republikës bashkëpunon me:

a) Policinë e Shtetit;

b) Shërbimin Informativ të Shtetit;

c) Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura;

ç) Protokollin e Shtetit, administratën e institucionit të Presidentit të Republikës, të kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, protokollet dhe kabinetet e institucioneve të tjera;

d) strukturën përgjegjëse që ofron shërbimin e urgjencës dhe të kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit;

dh) organet e ndryshme të administratës shtetërore;

e) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ë) komunitetin, shoqërinë civile dhe shërbimet e sigurisë private;

f) persona juridikë e fizikë dhe me çdo shtetas, kur lind një nevojë e tillë;

g) shërbimet homologe të shteteve të huaja, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe sipas protokolleve e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 10

Detyrime të subjekteve shtetërore dhe private

1. Protokollin e Shtetit dhe kabinetet e institucioneve, ku ushtrojnë veprimtarinë personalitetet, njoftojnë Gardën Republikës për kohën dhe vendin e zhvillimit të aktivitetit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë përpara fillimit të tij.

2. Strukturat shtetërore që ofrojnë shërbimin e urgjencës dhe të kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit dhe struktura që ka përgjegjësi për mirëqenien sociale të tyre detyrohen të bëjnë verifikimin e besueshmërisë.

3. Personat fizikë dhe juridikë, shtetërorë ose privatë, janë të detyruar të mos pengojnë punonjësit e Gardës të kryejnë detyrat për mbrojtjen e personaliteteve të vendit dhe të huaja, në rastet kur është i nevojshëm përdorimi i mjediseve në administrim apo në pronësi të tyre. Procedurat për kryerjen e veprimeve në mjediset



në administrim apo në pronësi të personave fizikë ose juridikë, shtetërorë ose privatë, përcaktohen në rregulloren e Gardës.

4. Të gjitha institucionet shtetërore detyrohen t'i japin menjëherë Gardës çdo informacion të mundshëm që rrezikon sigurinë e personaliteteve dhe të objekteve në ruajtje, sipas këtij ligji.

Neni 11 Kufizimet

Punonjësit të Gardës i ndalohet:

a) anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive ose të shoqatave politike, në çdo formë që shfaqen ato, në nivel qendror ose vendor, si dhe propaganda në favor ose kundër tyre apo kandidatëve në zgjedhje;

b) manifestimi i sjelljeve dhe mbajtja e qëndrimeve që cenojnë statusin e punonjësit të Gardës;

c) pjesëmarrja në grevë.

KREU III PERSONALITETET DHE OBJEKTET NË RUAJTJE E MBROJTJE

Neni 12 Personalitetet dhe objektet që ruhen e mbrohen nga Garda

1. Garda e Republikës ruan dhe mbron:

a) Presidentin e Republikës së Shqipërisë, kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe pjesëtarët e familjeve të tyre, kur kategorizimi dhe arsyet e marrjes në ruajtje dhe mbrojtje të pjesëtarëve të familjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) Presidentin e zgjedhur që nga momenti i votimit në Kuvend;

c) zëvendëskryetarin e Kuvendit, zëvendëskryeministrin, ministrin përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, ministrin përgjegjës për punët e jashtme;

ç) kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë;

d) personalitete të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) personalitetet e huaja të të njëjtit nivel me personalitetet shqiptare të përmendura në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, që

vijnë për vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë;

e) personalitetet e huaja në vlerësim dhe me kërkesë të Protokollit të Shtetit gjatë kohës së qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Garda e Republikës ruan dhe mbron:

a) objektet ku ushtrojnë veprimtarinë dhe akomodohen Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, si dhe banesat ku ata banojnë ose akomodohen;

b) objektet ku zhvillohen seancat plenare të Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare;

c) godinën e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme;

ç) objektet ku akomodohen dhe zhvillojnë veprimtarinë personalitetet e huaja të të njëjtit nivel me personalitetet e vendit të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, kur vijnë në vendin tonë;

d) objekte të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13 Ruajtja e personaliteteve pas lënies së detyrës

1. Presidenti i Republikës, pas përfundimit të mandatit, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për 5 (pesë) vjet. Në rast të ndërprerjes së mandatit, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë.

2. Kryetari i Kuvendit, pas përfundimit të mandatit, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për 4 (katër) vjet. Në rast të ndërprerjes së mandatit, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë.

3. Kryeministri, pas mbarimit të mandatit qeverisës, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për 4 (katër) vjet. Në rast të ndërprerjes së detyrës përpara mandatit qeverisës, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë.

4. Kohëzgjatja e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës nga ana e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 14

Kohëzgjatja e ruajtjes së objekteve

1. Objektet e përcaktuara në pikat 10 e 11, të nenit 5, të këtij ligji, ruhen dhe mbrohen deri në ndryshimin e statusit të tyre.

2. Banesa e Presidentit të Republikës, e kryetarit të Kuvendit dhe e Kryeministrit ruhen e mbrohen gjatë kohës së qëndrimit të tyre në detyrë. Pas përfundimit të detyrës, ruajtja dhe mbrojtja e banesës bëhet për një periudhë 2-vjeçare. Në rast të përfundimit të mandatit ose të lirimit nga detyra para afatit, ruajtja dhe mbrojtja bëhet deri në gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë, por jo më shumë se 2 (dy) vjet.

3. Kohëzgjatja e ruajtjes së banesës të personaliteteve të tjera përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

AUTORITETET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 15

Ministri

1. Ministri ka këto përgjegjësi dhe kompetenca:

a) harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarisë së Gardës;

b) përcakton drejtimit strategjike dhe objektivat e Gardës;

c) i kërkon drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës të raportojë për kryerjen e detyrave, si dhe për çështje të veçanta që lidhen me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;

ç) ushtron inspektim nëpërmjet strukturave të sistemit të ministrisë;

d) nxjerr akte administrative në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Gardës, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

dh) garanton bashkëpunim ndërmjet Gardës dhe strukturave të tjera të sistemit të ministrisë, institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe institucioneve homologe të vendeve të tjera në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara;

e) emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës me gradën Drejtues i Lartë me propozim të drejtorit të përgjithshëm;

ë) miraton strukturën dhe organikën e Gardës.

2. Ministri ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 16

Drejtori i përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës është autoriteti më i lartë ekzekutiv, organizativ, administrativ dhe operacional, i cili përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit për përmbushjen e misionit të Gardës.

2. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës ka këto kompetenca:

a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Gardës;

b) menaxhon burimet njerëzore dhe asetet financiare të Gardës;

c) nxjerr akte administrative për veprimtarinë e Gardës bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore;

ç) i propozon ministrit strukturën dhe organikën e Gardës;

d) përfaqëson Gardën në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit;

dh) nënshkruan marrëveshje teknike dhe operacionale, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

e) emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës, me përjashtim të gradës Drejtues i Lartë;

ë) ushtron kompetenca të tjera të parashikuara me ligj dhe në akte nënligjore.

Neni 17

Kriteret e emërimit të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës

1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit dhe i jepet grada “Drejtues madhor”.

2. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës duhet të plotësojë këto kriteret:

a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;

b) të jetë punonjës i Gardës që mban gradën “Drejtues i parë” ose “Drejtues i lartë”;

c) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore brenda 3 (tri) viteve të fundit;

ç) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.



3. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh me të drejtë riemërimi edhe për 5 (pesë) vjet të tjera.

Neni 18

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës lirohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit me propozim të ministrit.

2. Drejtori i përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

- a) humbet shtetësinë shqiptare;
- b) jep dorëheqjen;
- c) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 (gjashtë) muaj;
- ç) plotëson moshën për pension;
- d) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Drejtori i përgjithshëm shkarkohet nga detyra kur:

- a) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- b) nuk përmbushen objektivat strategjike për shkak të performancës së ulët të tij.

Neni 19

Zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive

1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës gjatë ushtrimit të kompetencave të tij mbështetet nga zëvendësdrejtorë të përgjithshëm.

2. Zëvendësdrejtori kryen detyrat që i caktohen nga drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës.

3. Zëvendësdrejtori emërohet nga ministri, nga punonjësit e Gardës që mbajnë gradën “Drejtues i parë” ose “Drejtues i Lartë”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Gardës. Në momentin e emërimit zëvendësdrejtori merr/ruan gradën “Drejtues i Lartë”.

4. Ministri cakton një zëvendësdrejtor të ushtrorë kompetencat dhe detyrat e drejtorit në rastet kur:

a) drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës nuk është emëruar ende;

b) në rast paaftësie ose pezullimi nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

5. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës nuk mund të ushtrorë kompetencat e drejtorit për një periudhë të pandërprerë, më shumë se 6 muaj.

6. Drejtorët e drejtorive në Gardën e Republikës mbajnë gradën “Drejtues i lartë”.

KREU V

PRANIMI, FORMIMI DHE ECURIA NË KARRIERË

Neni 20

Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës në Gardën e Republikës bazohen në parimet e mundësive të barabarta, të meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Pranimi në Gardë kryhet nëpërmjet procesit të konkurrimit të hapur.

2. Me përfundimin e shkollimit bazë dhe të studimeve/kualifikimeve, kursanti/studenti pranohet si punonjës i Gardës së Republikës, i jepet grada përkatëse “inspektor” ose “nënkomisar” dhe emërohet në detyrë.

3. Punonjësi i Gardës së Republikës, pas pranimi, i nënshtrohet periudhës 1-vjeçare të provës, e cila fillon në datën kur punonjësi emërohet në detyrë.

Neni 21

Kriteret e pranimi

1. Kriteret e përgjithshme të pranimi të shtetasit në Gardë janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- d) të jetë i moshës 19–30 vjeç;
- dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;



ë) të mos jetë në ndjekje penale;

f) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;

g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Në nivelin bazë, shtetasi pranohet si punonjës i Gardës së Republikës, kur, krahas plotësimit të kriterëve të përgjithshme, ka përfunduar edhe arsimimin për rolin bazë për punonjës të Gardës në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

3. Bazuar në nevojat e identifikuar për rekrutimin e punonjësve të nivelit të mesëm, në Gardën e Republikës pranohen edhe shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Pas përfundimit të kursit të formimit profesional, u jepet grada “nënkomisar”.

4. Pranohet si punonjës i Gardës së Republikës edhe shtetasi që ka përfunduar arsimin përkatës në institucionet arsimore homologe jashtë vendit të njësuara me programet e institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, Xhandarmërisë, Karabinierisë, Gardës Civile ose strukturave të tjera të njësuara me to dhe që diplomat e tyre janë njohur dhe ekuivalentuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Të gjithë kandidatët fitues, pas emërimit në detyrë, ndjekin programin e profilizimit të përcaktuar në politikat e arsimit të Gardës së Republikës.

Neni 22

Pranimi i punonjësve në funksione të veçanta

1. Për funksione të veçanta në Gardë, ku kërkohen njohuri specifike, të cilat nuk përfitohen në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose në institucionet e përmendura në nenin 21 të këtij ligji, pranohen, nëpërmjet konkurrit, shtetas që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të mos jetë i përjashtuar nga institucionet e administratës shtetërore, të institucioneve

ligjzbatuese dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil;

c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën;

d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë përkatës;

dh) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën përkatëse;

e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

2. Shtetasi që shpallet fitues pranohet në këto funksione pas përfundimit të kursit të formimit bazë profesional në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështje të rendit dhe sigurisë publike dhe i jepet grada që korrespondon me funksionin ku do të emërohet.

3. Shtetasi i pranuar në funksione të veçanta lejohet të aplikojë për ngritje në gradë/detyrë ose të transferohet në funksione të tjera vetëm nëse janë brenda të njëjtit profil. Atij nuk i lind e drejta për të aplikuar për ngritje në gradë/detyrë po të transferohet në funksione të tjera pa plotësuar një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.

4. Numri i shtetasve të pranuar, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se 3 (tre) për qind e limitit të përgjithshëm organik të Gardës së Republikës.

5. Procedurat, rregullat e konkurrit, funksionet e veçanta dhe transferimi brenda funksioneve të veçanta përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 23

Pranimi i ushtarakëve të FARSH-së në Gardën e Republikës

1. Për plotësimin e nevojave të veçanta, mund të pranohen në Gardën e Republikës ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 22, përjashtuar shkronjën “dh” të këtij ligji.

2. Për ushtarakët e shërbimit aktiv, pranimi realizohet me pëlqimin e ushtarakut dhe në bazë të marrëveshjes dypalëshe ndërmjet ministrit të mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë, pas nxjerrjes në lirim të ushtarakut, nga



autoritetet përgjegjëse të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Pranimi realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit për çështjet e rendit e të sigurisë publike.

4. Kalimi nga strukturat e FARSH-së te Garda e Republikës realizohet duke ruajtur dhe njohur vjetërsinë e shërbimit.

5. Procedurat, rregullat dhe mënyra e ekuivalentimit të gradave ushtarake me ato të Gardës së Republikës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Arsimimi dhe trajnimi

1. Arsimimi kryhet në:

a) institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;

b) institucione arsimore homologe jashtë vendit, të përcaktuara në politikat e arsimimit të Gardës së Republikës.

2. Trajnimet kryhen në:

a) institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;

b) strukturat përgjegjëse të Gardës për trajnimin;

c) institucione të tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit, sipas marrëveshjeve dypalëshe, në bazë të nevojave që i paraqiten Gardës së Republikës.

3. Garda i paraqet institucionit arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, çdo vit shkollor, kuotat e nevojshme për konkurrim, për funksionet me gradën “inspektor” dhe “nënkomisar”, si dhe trajnime për ecurinë në gradë e karrierë.

Neni 25

Betimi

1. Punonjësi, në momentin e emërimit në detyrë, bën betimin dhe, për këtë qëllim, nënshkruan deklaratën e betimit.

Punonjësi betohet sipas kësaj formule betimi:

“Si pjesëtar i Gardës së Republikës, betohem se do të jem besnik i popullit tim, trim, i disiplinuar, se do të zbatoj kërkesat e Kushtetutës e të ligjeve dhe do të jem i gatshëm përherë, duke mos kursyer as jetën për kryerjen e detyrës. Ndëshkimi më i rëndë i ligjeve le të më jepet, nëse shkel këtë betim solemn! Betohem!”

2. Refuzimi për të bërë betimin ose për të nënshkruar deklaratën e betimit sjell si pasojë anulimin e aktit të emërimit në detyrë.

Neni 26

Transferimi

1. Punonjësi transferohet nga një detyrë në një detyrë tjetër brenda së njëjtës gradë që mban.

2. Punonjësi transferohet në këto raste:

a) për nevoja shërbimi;

b) për plotësim të funksioneve organike;

c) për arsye shëndetësore që e kufizojnë në kryerjen e detyrës aktuale.

Neni 27

Transferimi në struktura të tjera me gradë

1. Punonjësi mund të transferohet në struktura me grada në varësi të ministritë për çështjet e rendit dhe sigurisë publike bazuar në kërkesat e këtyre të fundit.

2. Në rastet e transferimit, punonjësi i Gardës emërohet në funksionet e ofruara, duke iu ekuivalentuar grada që mban me funksionet dhe gradat në institucionin ku ai transferohet, sipas legjislacionit të këtij të fundit.

3. Koha e qëndrimit në detyrë në struktura/institucione të tjera me gradë në varësi të ministritë, njihet si vjetërsi në strukturat e Gardës së Republikës për punonjësin e Gardës.

4. Në përfundim të periudhës së qëndrimit në detyrë pranë strukturave/institucioneve të tjera me gradë në varësi të ministritë, punonjësi ka të drejtë të rikthehet në strukturat e Gardës në një funksion në përputhje me gradën që mban aktualisht.

5. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 28

Transferimi i përkohshëm

1. Punonjësi transferohet përkohësisht në një detyrë tjetër brenda Gardës në këto raste:

a) për zëvendësimin e përkohshëm të një punonjësi/e;

b) kur funksioni organik është i paplotësuar;

c) për përballimin e dinamikës së punës si rezultat i situatave të paparashikuara.

2. Kohëzgjatja e transferimit nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë) muaj.

3. Gjatë kohës së transferimit të përkohshëm punonjësit i ruhet vendi i punës dhe trajtohet me pagën e vendit të punës që ka pasur para transferimit.

4. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 29

Pezullimi

1. Punonjësi pezullohet nga detyra në rastet kur:

a) fillon ndjekja penale;

b) ka kryer veprime që cenojnë dinjitetin ose integritetin e institucionit, pas njoftimit nga organet ligjzbatuese, të përcaktuara në rregulloren e Gardës së Republikës.

2. Pezullimi nga detyra për shkaqet e përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni zgjat për aq kohë sa përfundon procedimi penal.

3. Vendimi për pezullim nga detyra dhe heqjen e masës së pezullimit bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës dhe i komunikohet punonjësit ndaj të cilit merret kjo masë.

4. Ndaj punonjësit që pezullohet nga detyra, drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës mund të vendosë:

a) heqjen e së drejtës për të hyrë i pashoqëruar në mjediset e institucionit dhe në objektet që ka në ruajtje;

b) heqjen e së drejtës për të mbajtur dokumentin e identifikimit si punonjës i Gardës, si dhe armatimin personal;

c) heqjen e së drejtës për të pasur akses në materialet me informacion të klasifikuar.

Neni 30

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe rikthimi

1. Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet në rastet si më poshtë:

a) kur mbush moshën për pension pleqërie;

b) deklarohet i paaftë për punë nga organi kompetent mjekësor;

c) i miratohet kërkesa për lirim;

ç) lë shtetësinë shqiptare;

d) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjykatë;

dh) bëhen shkurtime në funksionet organike dhe në numrin e përgjithshëm të punonjësve;

e) kur ka vlerësime të performacës në punë dhe të rezultateve të testimeve të nivelit nën mesatar për 2 (dy) herë rresht;

ë) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) shkel betimin;

g) cenon rëndë integritetin e institucionit;

gj) nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune.

2. Një punonjësi të liruar sipas shkronjave “c”, “dh” e “gj” të pikës 1 të këtij neni i lind e drejta të konkurrojë për t’u rikthyer në strukturat e Gardës kur krijohen vende të lira.

3. Rregullat e procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe rikthimit përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 31

E drejta e informimit dhe ankimit

1. Punonjësi ka të drejtën e informimit për fillimin e çdo procedimi administrativ apo disiplinor dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës.

2. Punonjësi, për rastet që mendon se lirimi, pezullimi ose përjashtimi nga puna është bërë pa shkaqe të justifikuara, ka të drejtë të paraqesë ankesë, sipas përcaktimeve në rregulloren e Gardës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.



Neni 32

Vlerësimi i punonjësit

1. Punonjësi u nënshtrohet testeve dhe vlerësimit vjetor periodik të punës.

2. Elementet që testohen e vlerësohen, procedura dhe kompetencat për vlerësimin përcaktohen në rregulloren e Gardës.

KREU VI

GRADAT

Neni 33

Gradat dhe hierarkia

1. Sistemi i gradave përcakton hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit në Gardën e Republikës.

2. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Hierarkia e punonjësit të Gardës përcaktohet nga grada, nga funksioni për punonjësit me të njëjtën gradë, nga vjetërsia në gradë për punonjësit me gradë dhe funksion të njëjtë.

4. Klasifikimet e niveleve sipas hierarkisë janë:

- a) bazë;
- b) i mesëm;
- c) i lartë;
- ç) madhor.

Neni 34

Emërtimi i gradave

Emërtimet e gradave sipas klasifikimit janë si më poshtë:

1. Punonjës i nivelit bazë:

- a) inspektor;
- b) inspektor i dytë;
- c) inspektor i parë.

2. Punonjës i nivelit të mesëm:

- a) nënkomisar;
- b) komisar;
- c) kryekomisar.

3. Punonjës i nivelit të lartë:

- a) drejtues;
- b) drejtues i parë.

4. Punonjës i nivelit madhor:

- a) drejtues i lartë;
- b) drejtues madhor.

Neni 35

Kriteret për fitimin e gradës

Ecuria në gradë e punonjësit të Gardës bëhet nëpërmjet fitimit të njëpasnjëshëm të gradave, në përputhje me kriteret e përcaktuara për çdo gradë, si më poshtë:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të ketë përfunduar arsimin dhe kualifikimin përkatës për gradën për të cilën konkurron, sipas përcaktimeve të nenit 38 të këtij ligji;

c) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë sipas të afateve të përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji.

Neni 36

Kriteret për aplikim për gradimin e radhës

1. Punonjësi i Gardës ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës së radhës kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të jetë shuar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në legjislacionin përkatës për Gardën e Republikës;

c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;

ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;

d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji.

2. Konkurrimi për fitimin e gradës bëhet vetëm për gradën pasardhëse.

Neni 37

Afatet e qëndrimit në gradë

1. Punonjësi i Gardës, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë këto afate:

a) nga “inspektor” deri në “inspektor i dytë” 5 vjet;

b) nga “inspektor i dytë” në “inspektor i parë” 10 vjet;

c) nga “nënkomisar” në “komisar” 3 vjet;

ç) nga “komisar” në “kryekomisar” 3 vjet;



- d) nga “kryekomisar” në “drejtues” 5 vjet;
dh) nga “drejtues” në “drejtues i parë” 3 vjet.

1.1. Punonjësit të Gardës në nivelin bazë, që ka vjetërsi shërbimi mbi 3 (tre) vjet, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës “nënkomisar”.

2. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë page.

3. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të:

- a) paaftësisë shëndetësore deri në 6 muaj, brenda afatit 12-mujor;
- b) vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;
- c) lejes së lindjes;
- ç) transferimit të përkohshëm në struktura të tjera.

Neni 38

Arsimimi dhe kualifikimet për fitimin e gradës

Kurset e detyrueshme për fitimin e gradës janë:

- a) për gradën “inspektor i dytë” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për inspektor të dytë;
- b) për gradën “inspektor i parë” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për inspektor të parë;
- c) për gradën “komisar” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për komisar;
- ç) për gradën “kryekomisar” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për kryekomisar;
- d) për gradën “drejtues” të ketë përfunduar masterin profesional në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- dh) për gradën “drejtues i parë” të ketë përfunduar kursin për “drejtues të parë”.

Neni 39

Dhënia dhe fitimi i gradës

1. Gradat nga “inspektor” deri “drejtues i parë” jepen nga drejtori i përgjithshëm i Gardës, ndërsa grada “drejtues i lartë” jepet nga ministri.
2. Grada “inspektor” i jepet punonjësit të Gardës pas përfundimit të shkollimit bazë.

3. Grada “nënkomisar” fitohet pas shpalljes fitues në procesin e konkurimit dhe përfundimit të ciklit të parë të studimeve të arsimit të lartë ose pas përfundimit të kursit përkatës në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministrit të përgjegjës për rendin dhe sigurinë për konkurrentët që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.

4. Gradat “inspektor i dytë”, “inspektor i parë”, “komisar”, “kryekomisar”, “drejtues” dhe “drejtues i parë” fitohen nëpërmjet konkurimit për gradë.

5. Gradat “drejtues i lartë” dhe “drejtues madhor” jepen në momentin e emërimit të punonjësit në funksionin që i korrespondojnë këto grada.

6. Komisionet e gradimeve ngrihen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

7. Rregullat dhe procedurat e zhvillimit të procesit të konkurimit për gradë përcaktohen në rregulloren e Gardës së Republikës.

Neni 40

Konkurrimi për gradë

1. Konkurrimi për gradën “inspektor i dytë” deri “inspektor i parë” dhe “komisar” deri “drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces testimi e vlerësimi.

2. Drejtori i përgjithshëm shpall fillimin e konkurimit për gradë pas evidentimit të vendeve të lira nga struktura e Burimeve Njerëzore.

3. Konkurrimi për gradë bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse.

4. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurimit e kanë të gjithë punonjësit e Gardës që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

5. Procedurat e konkurimit përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 41

Fazat e testimit të kandidatëve

1. Për fitimin e gradës “komisar” kandidati vlerësohet në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë.

2. Për fitimin e gradës “kryekomisar” deri në “drejtues i parë” kandidati vlerësohet në testimin



me shkrim, me ushtrime vlerësuese dhe intervista me gojë.

3. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës që në momentin e shpalljes së fazës së aplikimeve, por ai nuk mund të jetë më i ulët se 70% (shtatëdhjetë).

Neni 42

Ankimi për gradën

1. Punonjësi i Gardës ka të drejtën e ankimit kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit pranë Komisionit të Apelimit në çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.

2. Kundër vendimit të Komisionit të Apelimit, punonjësi i Gardës ka të drejtë të ankohet në gjykatë.

3. Përbërja, detyrat dhe kompetencat e Komisionit të Apelimit, si dhe rregullat e procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 43

Përcaktimi i gradave korresponduese për çdo funksion

1. Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese.

2. Përcaktimi i gradave korresponduese për çdo funksion miratohet me urdhër të ministrit.

KREU VII

TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 44

Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës për punonjësit njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës shtetërore.

2. Për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, koha e punës ditore mund të zgjatet tej kohës normale të punës me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës ose të drejtuesit të strukturës. Në këto raste punonjësi kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Punonjësi gëzon të drejtën e pushimit vjetor, si dhe të pushimeve të tjera të pagueshme.

4. Pushimi vjetor për punonjësit e Gardës së Republikës është 28 (njëzet e tetë) deri në 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar sipas funksioneve e gradave.

Neni 45

Leja pa të drejtë page

1. Punonjësi gëzon të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj ose afatgjatë deri në 3 (tre) vjet.

2. Leja afatshkurtër jepet nga drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës dhe, pas përfundimit të lejes, punonjësi kthehet në të njëjtën detyrë.

3. Leja afatgjatë jepet vetëm për studime nga drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës.

4. Rregullat dhe procedurat e lejes pa të drejtë page përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 46

Kujdesi për punonjëset e Gardës

1. Punonjëset kryefamiljare të vetme, me fëmijë të mitur dhe shtatzëna nuk mund të punojnë në funksione pune gjatë turneve të natës apo të papërshtatshme për shkak të statusit të tyre, përveçse në rastet kur me vullnet të lirë zgjedhin ta kryejnë.

2. Punonjësja e Gardës nuk mban uniformë në muajt e dukshëm të shtatzënisë.

3. Funksionet e punës që dëmtojnë shëndetin e punonjësve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me rregullore të Gardës.

Neni 47

Leja e lindjes

1. Punonjëset shtatzëna gëzojnë të drejtën e lejes së paralindjes dhe të paslindjes sipas legjislacionit në fuqi.

2. Pagesa e punonjësve për rastet e lejelindjes përcaktohet nga ligji për sigurimet shoqërore.



Neni 48

Trajtimi financiar në marrëdhënie pune

1. Punonjësi, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë, trajtohet me:

- a) pagë mujore bruto, e cila përbëhet nga:
 - i. paga për gradë;
 - ii. shtesa mbi pagë për vjetërsi shërbimi;
 - iii. shtesa mbi pagë për natyrë të veçantë pune;
 - iv. shtesa mbi pagë për dëme në shëndet;
 - v. shtesa mbi pagë për funksione të veçanta;
- b) trajtim me ushqim;
- c) ndihmë financiare në rastet e fatkeqësive në familje;
- ç) shpërblim deri në masën e tri pagave mujore;

d) ndihmë të menjëhershme financiare, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit.

2. Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 49

E drejta për sigurim shëndetësor

1. Punonjësit e strukturave të veçanta të Gardës, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, gëzojnë të drejtën për sigurimin shëndetësor për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Ky sigurim realizohet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, i cili mbulon shpenzimet për kontrollin parandalues, diagnostifikues e kurues, të ofruara nga institucionet e shëndetësisë, brenda dhe jashtë vendit.

3. Lista e shërbimeve shëndetësore, autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe strukturat e veçanta që përfitojnë sipas këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

E drejta për përfitim kredie me interesa të buta

1. Punonjësit të pastrehë i jepet kredi për strehim me kushte lehtësuese, mbështetur nga buxheti i shtetit.

2. Kriteret, masa e përfitimit, interesat dhe procedura për fitimin dhe ndërprerjen e kredisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 51

Kompensim për strehim

1. Kur punonjësi i nivelit të mesëm e të lartë emërohet ose transferohet në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm, kur nuk i sigurohet nga Garda mjedisi për akomodim, ai kompensohet për shpenzimet e strehimit.

2. Masa ditore e përfitimit dhe procedura e kompensimit për strehim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Mbrojtja e veçantë

1. Në rast se punonjësit ose ndonjë pjesëtari të familjes së tij i kërcënohet jeta për shkak të detyrës, ai gëzon të drejtën për mbrojtje të veçantë.

2. Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësit përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 53

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës

1. Punonjësi që ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin përfiton:

- a) pagesë kalimtare;
- b) pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
- c) pension shërbimi;
- ç) pension suplementar mbi pensionin e pleqërisë.

2. Trajtimi financiar për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet me ligj të veçantë.



Neni 54

Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës

1. Kur punonjësi humb jetën në krye ose për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë:

a) ndihmë të menjëhershme financiare deri në 10 (dhjetë) paga mujore, sipas pagës së muajit të fundit të shërbimit;

b) pension familjar suplementar në masën 100% (njëqind) të pagës së muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Përfitimet jepen në vlerën 100 % (njëqind) të pagës, sa herë që paga sipas së cilës është llogaritur ky përfitim ndryshon;

c) rimbursim në masën 100% (njëqind) të bursës së studimit në institucionet e arsimit shtetëror për fëmijët e punonjësit;

ç) banesë falas për bashkëshorten dhe fëmijët kur janë të pastrehë;

d) ndihmë financiare në masën e 1 (një) page mujore çdo përvjetor vdekjeje;

dh) ceremonia mortore organizohet nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhen nga buxheti i Gardës së Republikës;

e) punësim me prioritet për fëmijët në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme për vendin e punës.

2. Familjet e shtetasve, të cilët humbin jetën për shkak të kryerjes së detyrave në ndihmë të strukturave të Gardës së Republikës, përfitojnë në mënyrë të njëjtë çdo ndihmë dhe trajtim të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Përfitimet për këtë kategori caktohen në bazë të pagës mujore të tyre dhe për shtetasit që nuk janë në marrëdhënie pune caktohen në bazë të pagës mujore të gradës “inspektor”.

3. Rregullat dhe procedurat e detajuara për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII
DISIPLINA

Neni 55

Sjellja dhe etika

1. Punonjësi është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes e të etikës gjatë përmbushjes së detyrave.

2. Normat dhe rregullat e sjelljes dhe të etikës përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 56

Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit, që bie në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloren e Gardës.

2. Shkeljet disiplinore kategorizohen në shkelje të lehta dhe të rënda.

3. Punonjësi që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet:

a) për shkelje të lehta disiplinore me masat:

i. vërejtje;

ii. vërejtje me paralajmërim.

b) për shkelje të rënda disiplinore me masat:

i. mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë mujore;

ii. shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 (dy) vjet;

iii. përjashtim nga Garda e Republikës.

4. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:

a) 6 (gjashtë) muaj nga njoftimi i masës “vërejtje”;

b) 1 (një) vit nga njoftimi i masës “vërejtje me paralajmërim”;

c) pas mbarimit të afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 (dy) vjet”.

5. Efektet e masës disiplinore për punonjësin fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihet edhe procedura përkatëse e ankimit.

6. Punonjësi administrativ për shkeljet e kryera ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në kontratën e punës.

7. Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në rregulloren e Gardës.



Neni 57

Ankimi ndaj shkeljeve disiplinore

1. Punonjësi ndaj të cilit merret masë për shkelje të lehtë disiplinore, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që i ka dhënë masën brenda 5 (pesë) ditëve nga çasti i marrjes në dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

2. Punonjësi ndaj të cilit merret masë për shkelje të rëndë disiplinore, ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

3. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurës Administrative.

4. Punonjësi ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.

5. Procedurat për zbatimin e këtij neni, përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Apelit përcaktohen në rregulloren e Gardës.

KREU IX
SIMBOLET, UNIFORMA, SHENJAT
DALLUESE, DOKUMENTI
I IDENTIFIKIMIT DHE FESTA E
GARDËS

Neni 58

Simbolet

1. Garda e Republikës identifikohet me flamurin dhe stemën.

2. Flamuri dhe stema miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 59

Uniforma dhe shenjat dalluese

1. Punonjësi kryen detyrat e shërbimit me uniformë dhe shenja dalluese të veçanta. Uniforma dhe shenjat dalluese përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij.

2. Punonjës të strukturave të veçanta, të përcaktuara me urdhër të drejtorit të

përgjithshëm të Gardës së Republikës, trajtohen me veshje civile.

3. Uniforma, shenjat dalluese dhe normat e veshmbathjes së punonjësve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 60

Dokumenti i identifikimit

1. Punonjësi gjatë kryerjes së detyrës identifikohet me dokumentin individual të identifikimit.

2. Përmbajtja dhe formati i dokumentit të identifikimit përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 61

Festa e Gardës së Republikës

Festa e Gardës së Republikës është data 24 qershor.

KREU X
ARMËT, PAJISJET, PAJISJET
KUFIZUESE, PËRDORIMI I FORCËS DHE
MJETET E TRANSPORTIT

Neni 62

Armët, pajisjet dhe mjetet

1. Punonjësi ka të drejtë të mbajë armë dhe pajisje personale.

2. Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve e pajisjeve të tjera kufizuese për përdorimin e forcës nga Garda përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përdoren vetëm në kuadër të detyrës.

3. Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësit e Gardës përdorin mjete lëvizëse motorike ose mjete të blinduara për shërbime të veçanta, ngjyra, shenja dhe përdorimi i të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63

Përdorimi i forcës

1. Punonjësi nuk e përdor forcën, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve, për vetëmbrojtje



dhe vetëm për të ndaluar aktet e dhunshme. Në këto raste, forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk ka karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

3. Në çdo rast ndalohet përdorimi i forcës për qëllime trajtimi çnjerëzor ose degradues.

KREU XI BURIMET FINANCIARE

Neni 64 **Buxheti i Gardës**

1. Buxheti i Gardës është program i veçantë brenda buxhetit të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

2. Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve në përdorim ushtrohen sipas legjislacionit financiar në fuqi.

Neni 65 **Donacionet dhe sponsorizimet**

Garda pranon donacione dhe sponsorizime. Pranimi, administrimi dhe përdorimi i tyre bëhen në bazë të legjislacionit në fuqi.

KREU XII CERTIFIKATAT

Neni 66 **Certifikata për shërbim të dalluar dhe karrierë**

Ministri përgjegjës për çështjet e rendit e të sigurisë publike dhe drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës japin certifikata për punonjësit e dalluar në kryerjen e detyrave, si dhe për shtetas të ndryshëm që kontribuojnë për realizimin e detyrave nga Garda.

Neni 67 **Llojet e certifikatave**

1. Llojet e certifikatave janë:

a) certifikatë për shërbime të dalluara;

b) certifikatë karriere.

2. Rregullat, kriteret, procedurat, kompetencat për dhënien e certifikatave përcaktohen në rregulloren e Gardës.

KREU XIII DISPOZITA KALIMTARE DHE ZBATUESE

Neni 68 **Kalimi në sistemin e ri të gradave**

Njësimi i gradave të fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë” me gradat sipas këtij ligji bëhet si më poshtë:

a) gradat: “rreshter”, “kapter i katërt”, “kapter i tretë” dhe “kapter i dytë” ekuivalentohen me gradën “inspektor”;

b) gradat: “kapter i parë”, “kapter mjeshtrë” dhe “kapter shtabi” ekuivalentohen me gradën “inspektor i dytë”;

c) gradat: “kapter” dhe “kryekapter” ekuivalentohen me gradën “inspektor i parë”;

ç) gradat: “nëntoger” dhe “toger” ekuivalentohen me gradën “nënkomisar”;

d) gradat: “nënkapiten” dhe “kapiten” ekuivalentohen me gradën “komisar”;

dh) grada “major” ekuivalentohet me gradën “kryekomisar”;

e) grada “nënkolonel” ekuivalentohet me gradën “drejtues”;

ë) grada “kolonel” ekuivalentohet me gradën “drejtues i parë” dhe/ose “drejtues i lartë”;

f) grada “gjeneral” ekuivalentohet me gradën “drejtues madhor”.

Neni 69 **Trajtimi gjatë periudhës tranzitore**

1. Kalimi nga sistemi i gradave të fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës” me gradat sipas këtij ligji bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Nëse numri i gradave është më i lartë se numri respektiv i funksioneve korresponduese për çdo gradë, punonjësi merr gradën që i korrespondon funksionit të lirë dhe, nëse nuk pranon, ai lirohet me gradën e fituar.



3. Nëse numri i gradave është me i ulët se numri përkatës i funksioneve korresponduese për çdo gradë, kompletimi organik deri në përfundim të procesit të konkurrimit për ecurinë në gradë bëhet nga punonjës që mbajnë një gradë më të ulët se ajo që i korrespondon funksionit të pakompletuar.

4. Trajtimi financiar i punonjësve gjatë qëndrimit në punë deri në momentin e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore përkatëse të parashikuara në këtë ligj do të vazhdojë të bëhet sipas dispozitave të akteve të mëparshme nënligjore.

Neni 70

Rregullorja e Gardës

Rregullorja e Gardës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 71

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2; 12, pikat 1, shkronjat “a” dhe “d”, 2, shkronja “d”; 13, pika 4; 14, pika 3; 23, pika 5; 27, pika 5; 33, pika 2; 48, pika 2; 49, pika 3; 50, pika 2; 51, pika 2; 54, pika 3; 58, pika 2; 59, pika 3; 62, pikat 2 dhe 3, dhe 70.

2. Ngarkohet ministri që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 1; 6, pika 3; 8, pika 3; 22, pika 5; 23, pika 3, dhe 43, pika 2.

3. Efektet financiare për aktet nënligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni fillojnë të zbatohen nga hyrja në fuqi e tyre, përveç akteve nënligjore në zbatim të neneve 49, pika 3, dhe 50, pika 2, të cilat do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2024.

Neni 72

Shfuqizime

Ligji nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, si dhe dispozita të tjera ligjore e nënligjore në fuqi që

Faqe| 5346

bien ndesh me këtë ligj shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 73

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.3.2021.

Shpallur me dekreten nr. 12056, datë 29.3.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET

Nr. 12056, datë 29.3.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të neni 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 173, datë 23.3.2021

PËR NJË SHITESË NË NUMRIN ORGANIK TË PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2021, shtohet me 30



(tridhjetë) veta, për Policinë e Shtetit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të ministrisë në 15109 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntë) punonjës.

2. Numri rezervë i punonjësve për vitin 2021 reduktohet me 30 (tridhjetë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 20 (njëzet) veta.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 176, datë 24.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 446, DATË 22.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PERSONELIT TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 19, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... 11 645 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) punonjës ...” zëvendësohen me “... 11 802 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dy) punonjës ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 181, datë 25.3.2021

PËR KRIJIMIN, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE KLASIFIKIMIN E ZONËS DOGANORE, AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Krijimin e zonës doganore të përhershme, Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit, në brendësi të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Shtrirja e zonës doganore është në një sipërfaqe prej 781 682 m², sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.


3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



INVESTITORI/INVESTOR  KUKES International Airport	PROJEKTUES/DISEIGNER  "InfraKonsult" shpk	"Runway Extension Kukes International Airport" /Zgjalimi i pistes se aeroportit te Kukesit Planimetria / Planview	PROJEKT ZBATIMI DETAILED DESIGN SHKALLA / SCALE Data: 2020 Date: 2020 FLETA / PAGE 1/10	OBJEKTOR PROJECT/PROJECT MANAGER Ing. Sulejman Shemshiri INGENIER PROJEKTUES/ DESIGN ENGINEERS: Ing. Riza STRUGAR Ing. Omer KALLA Ing. Oget MERITA Ing. Nermina TALLUSHI Ing. Renata LLOZI
--	---	--	--	--





**VENDIM****Nr. 18, datë 24.3.2021**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË
NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE,
ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pika 2 shkronja “b”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga banka e parë e investimeve, Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shitesë të faktoringut.
2. Autorizohet guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së bankës së parë të investimeve, Albania sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko**

VENDIM**Nr. 1, datë 19.3.2021**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar; si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, KDZH-ja, e ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, u mblodh më datë 19.3.2021, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

- Fondi 14/APSTR, viti 1991

Dosja nr. 3, 4, 10, 13, 14,15, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 31, 32, 35, 37, 39, 40, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 49, 50, 51, 56, 57, 58, 59, 60, 62, 64, 66, 67, 74, 75, 77, 80, 88, 94, 102, 103, 109, 110, 112, 113, 115, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 125, 128, 130, 131.

Niveli i klasifikimit “Sekret”

Dosjet propozohen të deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika “b” e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017.

2. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

3. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Ardi Bido**



URDHËR
Nr. 19, datë 26.3.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të neneve 59 dhe 78 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të parashikuara në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Rudin Baqli.

2. Delegimi i kompetencave, të parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri, bëhet për të gjitha kompetencat për të cilat lejohet delegimi sipas nenit 19, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, z. Rudin Baqli, si dhe administrata e Këshillit të lartë Gjyqësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Naureda Llagami

VENDIM
Nr. 84, datë 4.3.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
TIRANË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe të vendimit të

Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.3.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për licencim

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë) me shkresën nr. 8158 prot., datë 19.5.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit dhe të ndryshimit të popullsisë në zonën e shërbimit.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë) me shkresat nr. prot. 8158/1, datë 22.6.2020, nr. prot. 18963, datë 12.11.2020, nr. prot. 8158/2, datë 9.12.2020, nr. prot. 8158/3, datë 8.1.2021, nr. prot. 8158/4, datë 18.1.2021 dhe nr. prot. 2337, datë 10.2.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) plotësimet dhe sqarimet përkatëse të dosjes së aplikimit për rinovim licence.

3. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Tiranë dhe të ndryshimit të popullsisë në zonën e shërbimit, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).



4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) UK Tiranë ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për shkak të riorganizimit të shoqërisë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 63;

b) shoqëria UK Tiranë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 799,990 banorë në Bashkinë Tiranë, përveç njësive administrative Baldushk, Pezë, Farkë, Bërzhitë dhe Krrabë që nuk janë të mbuluara me akt miratime higjieno-sanitare;

c) drejtuesit teknik të shoqërisë UK Tiranë sh.a. plotësojnë kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të popullsisë së zonës së shërbimit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tiranë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., me NUIS L72320033P, në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria B - Për përpunimin e ujit për konsum publik;

c) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Elton Kacidhja;

b) Drejtues teknik: Enton Osmani;

c) Drejtues teknik: Edgar Cani.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., për të cilën jepet kjo licencë është:

Njësia administrative nr. 1; Njësia Administrative nr. 2; Njësia Administrative nr. 3; Njësia Administrative nr. 4; Njësia Administrative nr. 5; Njësia Administrative nr. 6; Njësia Administrative nr. 7; Njësia Administrative nr. 8; Njësia Administrative nr. 9; Njësia Administrative nr. 10; Njësia Administrative nr. 11; Njësia Administrative Dajt; Njësia Administrative Kashar; Njësia Administrative Ndroq; Njësia Administrative Petrelë; Njësia Administrative Shëngjergj; Njësia Administrative Vaqarr; Njësia Administrative Zall Bastar; Njësia Administrative Zall Herr.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare me qëllim lënien e një afati kohor të arsyeshëm për shkak të pandemisë COVID-19, në mënyrë që shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. të sigurojë aktet e miratimit higjieno-sanitar dhe për njësitë administrative për të cilat ende nuk është arritur të merret ky akt.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



VENDIM
Nr. 85, datë 4.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 40, DATË 1.6.2018, “PËR LICENCIMIN
E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
TROPOJË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.3.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 40, datë 1.6.2018, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tropojë (UK Tropojë), me shkresën nr. 07 prot., datë 6.1.2021, me lëndë “Informacion mbi emërimin e administratorit të UK Tropojë, z. Visard Byberi”, shkresën nr. 14 prot., datë 11.1.2021, me lëndë “Kërkesë emërimi të z. Visard Byberi drejtues teknik dhe ligjor”, shkresën nr. 47 prot., datë 2.2.2021, me lëndë “Dokumentacion mbi drejtuesin teknik z. Gerti Brahaj”, shoqëria ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Tropojë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, ndërsa kërkesën e shoqërisë për ndryshim të drejtuesit teknik aktual z. Visard Byberi me z. Gerti Brahaj, jo në konformitet me kriteret e parashikuara në VKM-në nr. 958.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Tropojë për herë të fundit me vendimin nr. 40, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Tropojë sh.a. z. Visard Byberi, ka mbaruar studimet e larta në Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike në vitin 2018, i cili aktualisht është dhe drejtues teknik i shoqërisë.

5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tropojë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, evidencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Tropojë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 40, datë 1.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: Visard Byberi.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



VENDIM
Nr. 86, datë 4.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 62,
DATË 6.9.2018, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË UJËSJELLËS-
KANALIZIME SARANDË SHA”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.3.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë (UK Sarandë), me shkresat nr. 69 prot., datë 5.11.2020, me lëndë: “Kërkesë për ndryshim të zonës së shërbimit të UK Sarandë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për ndryshim të zonës së shërbimit, dokumentacionin e nevojshëm mbi shkëputjen e njësisë administrative Aliko, Finiq, Dhiver, Mesopotam të Bashkisë Finiq që më parë shërbehehin nga UK Sarandë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit të UK Sarandë në konformitet me kriteret dhe procedurën e

parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Sarandë me vendimin nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë sh.a.” me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

Bashkia: Sarandë.

Bashkia: Finiq (pjesërisht)

Nj. Admin. Finiq, fshati Vrion;

Nj. Admin. Aliko, fshatrat Aliko, Çaus, Neohor, Tremul;

Nj. Admin. Dhiver, fshati Navaricë,

Nj. Admin. Mesopotam, fshatrat Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Sarandë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit të KKRR-së nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë sh.a. është Bashkia Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 87, datë 4.3.2021

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
LUSHNJË SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë



6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.3.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë (UK Lushnjë), me shkresën nr. 79 prot. ERRU, datë 11.2.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Lushnjë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Lushnjë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 92 000 banorë të Bashkisë Lushnjë;

b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Xhesikjana Boçi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, profili energjitik, në nëntor të vitit 2020.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Lushnjë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Lushnjë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a., me (NUIS K04223405T), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Erjet Dhima;

b) Drejtuese teknike: Xhesikjana Boçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. është Bashkia Lushnjë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë